

ISIDA FOÇI (METAJ) & EDLIRA JORGAQI


LIDHJET E FOLJES ME NDAJFOLJE QË TREGOJNË VAZHDIMËSI E PËRSËRITJE NË GJUHËN GREKE

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të merremi me një kategori të caktuar ndajfoljesh, pikërisht të atyre që tregojnë vazhdimësi dhe përsëritje të veprimit të shprehur nga folja. Në gjuhën greke përdorimi i tyre ndikon dhe në aspektin e foljes së përdorur në fjali. Këto ndajfolje tregojnë shumë pak për kohën e kryerjes së veprimit dhe më shumë kanë të bëjnë me aspektin e foljes.

1. Hyrje

Për kategorizimin e ndajfoljeve të kohës në gjuhën greke ka disa mendime. Sipas Triandafilidhisit¹ ato janë të grupuara në një kategori dhe quhen ndajfolje të kohës. Por Quirk dhe Greenbaum² janë të mendimit se në kategorinë e ndajfoljeve të kohës ekziston një dallim midis ndajfoljeve që tregojnë kohë, ato që i përgjigjen pyetjes kur, ndajfoljeve që tregojnë përsëritje apo frekuencë, ndajfoljeve që tregojnë vazhdimësi dhe atyre që tregojnë konsekuencë. Tabela e mëposhtme na njeh me disa shembuj:



2. Marrëdhëniet e foljes me ndajfoljet që tregojnë vazhdimësi dhe përsëritje

Lidhur me ndajfoljet e kohës mund të themi se ato na tregojnë pak gjëra për sa i përket kohës së foljes, por na tregojnë shumë për sa i përket aspektit. Këto ndajfolje i ndajmë në dy nënkategori: a) ndajfolje që tregojnë vazhdimësi (*όλο το πρωί, όλη τη μέρα, όλο το χρόνο*) dhe b) ndajfolje që tregojnë përsëritje

¹ M. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*: ΟΕΔΒ. Αθηνέ. 1941, f. 184.

² R. Quirk, S. Grenbaum, *A University Grammar of English*, Londër: Longman, 1973.

(*συχνά, πάντα, κάθε μέρα*). Ndajfoljet që tregojnë kohë absolute janë neutrale përkundrejt aspektit të kryer a të pakryer të foljes. Shohim shembujt:

- a. Κοιμόταν χτες / Flinte dje
- b. Κοιμήθηκε χτες / Fjeti dje

Ndajfoljet që tregojnë vazhdimësi përdoren me folje të aspektit të kryer dhe të pakryer. Mund të thuhet se vazhdimësia që shprehin për shkak të kuptimit të tyre leksikor, mund të neutralizohet në varësi të veprimit në tërësi:

- a. Κοιμόταν (θα κοιμάται) όλο το πρωί / Flinte (do të flejë) gjithë mëngjesin
- b. Κοιμήθηκε (θα κοιμηθεί) όλο το πρωί / Fjeti (do të flejë) gjithë mëngjesin

Ndajfoljet që tregojnë përsëritje nuk mund të përdoren në fjali me folje të aspektit të kryer:

- a. Κοιμόταν (θα κοιμάται) πάντα / Flinte (do të flejë) gjithmonë
- b. *Κοιμήθηκε (*θα κοιμηθεί) πάντα / Fjeti (do të flejë) gjithmonë

Ka edhe raste kur kuptimi i foljes së fjalisë kryesore kushtëzon aspektin e foljes së fjalisë varur. Kështu kemi:

- a. Σταμάτησα να γράφω
- b. *Σταμάτησα να γράψω

} Ndalova të shkruaj

Në rastin e fjalive të nënrenditura luan rol edhe kuptimi leksikor i lidhëzës. Lidhëza që tregojnë përsëritje si: *κάθε φορά που (çdo herë që), κάθε στιγμή που (çdo çast që)*, e përjashtojnë përdorimin e aspektit të kryer:

- a. Κάθε φορά που έφευγες, έκλαιγα / Çdo herë që ikje, qaja
- b. *Κάθε φορά που έφευγες, έκλαιγα / Çdo herë që ike, qaja

Siç pamë edhe nga shembujt, duket se kemi nevojë për dallime më të hollësishme për të kuptuar më saktë diferencën midis dy kategorive të ndajfoljeve të kohës. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis kohëzgjatjes dhe aspektit. Sipas Comrie³ aspekti i kryer përkufizohet si “mënyrë këndvështrimi e ngjarjeve me anë të të cilës shqyrtojmë ngjarjen në tërësinë e vet pa ndonjë dallim të pjesshëm lidhur me strukturën e brendshme”. Ndërsa aspekti i pakryer përkufizohet si “mënyrë këndvështrimi e ngjarjeve me anë të të cilës shqyrtojmë ngjarjen në zhvillim d.m.th. gjatë fazave të njëpasnjëshme të strukturës së brendshme”. Sigurisht që përdorimi i njërit apo tjetrit aspekt nuk bazohet në natyrën ondologjike të ngjarjeve, por në këndvështrimin subjektiv të ngjarjeve nga ana e folësit. Kështu për shembull duke u bazuar tek kundërvënia aspekt i kryer-aspekt i pakryer, mundet që e njëjta ngjarje të paraqitet njëherë si ndodhi (*το τρένο έφτασε στο σταθμό / treni arriti në stacion*), e një herë si proces (*το τρένο φτάνει/έφτανε στο σταθμό/treni arrin / arrinte në stacion*). Ndërsa proceset karakterizohen nga kohëzgjatja (kanë fillim, zhvillim e fund), kuptimi që mbart folja “arrij” e përjashton

³ B. Comrie, *Aspect*. Cambridge University Press. 1976, f. 16.

kohëzgjatjen: **Το τρένο φτάνει/έφτανε στο σταθμό επί δύο ώρες / Treni arrin/arrinte në stacion gjatë dy orëve*. Të tilla folje janë: *ξεχνώ / harroj, πεθαίνω / vdes, βρίσκω / gjej, κατορθώνω / ia dal, τερματίζω / përfundoj, αρχίζω / filloj*. Por këto folje mund të tregojnë përsëritje p.sh.: *Το τρένο φτάνει/έφτανε στο σταθμό καθημερινά στις 6 / Treni arrin/arrinte çdo ditë në stacion në 6*.

Disa folje përdoren në aspektin e kryer për të treguar fillimin dhe vazhdimin e një veprimi, por jo fundin. Kështu aspekti i kryer i këtyre foljeve nuk na informon nëse mbaron ose jo një situatë e caktuar. Ky informacion merret nga konteksti:

- a. Ο Γιάννης αρρώστησε σοβαρά / Jani u sëmur rëndë
- b. Ο Γιάννης αρρώστησε σοβαρά για μια εβδομάδα / Jani u sëmur rëndë për një javë

Folja në fjalinë e parë nuk na informon lidhur me fundin e sëmundjes së Janit. Nuk dimë nëse vazhdon apo jo sëmundja. Por në fjalinë e dytë, falë frazës *για μια εβδομάδα*, që tregon vazhdimësinë e sëmundjes, arrijmë me siguri në përfundimin se sëmundja ka mbaruar.

Sipas Vendlerit⁴ për të bërë dallimin midis një “procesit të plotësuar” dhe një “procesit të paplotësuar” mund të përdorim kriterin e mëposhtëm: Ndërsa pyetja *επί πόσην ώρα έγραφε/έγραψε / për sa kohë shkruante/shkroi* është e saktë, pyetja **μέσα σε πόσην ώρα έγραφε/έγραψε / brenda sa kohe shkruante/shkroi*, nuk është e saktë, siç nuk është e saktë edhe **πόσην ώρα έκανε/του έπαιρνε (του πήρε) για να γράφει/γράψει / sa kohë bënte/i merrte (i mori) për të shkruar*. Pyetja e saktë do të ishte: *μέσα σε πόσην ώρα έγραφε/έγραψε το γράμμα; / Brenda sa kohe e shkruante/shkroi letrën? ose Πόσην ώρα έκανε/του έπαιρνε (του πήρε) για να γράψει το γράμμα; / Sa kohë i bëri/i merrte(i mori) për të shkruar letrën?*

Sipas Vendlerit⁵, dalim në përfundimin se “*γράφω ένα/το γράμμα / shkruaj një letër/letrën*” është një proces i plotësuar në kundërshtim me foljen *γράφω/shkruaj* që nuk tregon proces të plotësuar. Ai bën dhe një tjetër dallim interesant. Gjendjet i ndan në “të veçanta” dhe “të përgjithshme”. Të veçanta janë gjendjet e duhanpirësit, të piktorit, të shoferit etj., ndërsa të përgjithshme të mbretit, të drejtuesit, të shërbëtorit etj. Ndryshimi qëndron në faktin se ndërsa shoferi mund të thotë se drejtoi makinën gjithë mëngjesin, kryeministri nuk mund të thotë se drejtoi vendin gjithë mëngjesin. Shpjegimi ka të bëjë me faktin se ndërsa drejtimi i makinës përbën një proces unik, si dhe duhanpirja apo piktura, veprimet që një drejtues/qeveritar supozohet se realizon janë të larmishme dhe të shumta në numër.

⁴ Z. Vendler, *Linguistics in Philosophy*. Cornell University Press. 1967, f. 100.

⁵ Po aty.

Le t'i rikthehem dhe njëherë ndarjes që i bëmë ndajfoljeve të kohës në ndajfolje që tregojnë vazhdimësi dhe ndajfolje që tregojnë përsëritje. Ndajfoljet e kategorisë së parë janë pothuajse asnjëherë përsa i përket aspektit të kryer a të pakryer të foljeve. Me përjashtim të disa rasteve ku ndajfolje si: *διαρκώς, συνέχεια* (vazhdimisht) dhe lidhëza *ενώ/ndërsa* nuk e pranojnë aspektin e kryer. Kështu kemi:

a. Έβρεχε όλο το πρωί/ως το βράδυ/διαρκώς/συνέχεια / Binte shi gjithë mëngjesin/vazhdimisht

b. Έβρεξε όλο το πρωί/ως το βράδυ/*διαρκώς/*συνέχεια / Ra shi gjithë mëngjesin/vazhdimisht

c. Έχει βρέξει όλο το πρωί/ως το βράδυ/*διαρκώς/*συνέχεια / Ka rënë shi gjithë mëngjesin/vazhdimisht

Disa folje që e mbartin në vetvete kuptimin e çastit përdoren me ndajfolje të kategorisë së parë vetëm në aspektin e pakryer:

a. Τα τρένα έφταναν/έφτασαν όλο το πρωί/από το πρωί ως το βράδυ / Trenat mbërrinin/mbërritën gjithë mëngjesin/nga mëngjesi deri në darkë

b. Όλο το πρωί πάθαινε/*έπαθε κρίσεις / Gjithë mëngjesin pësonte/pësoi kriza

Po të shohim shembujt:

a. Έτρωγε στο εστιατόριο επί δύο ολόκληρες ώρες/ Έφαγε στο εστιατόριο επί δύο ολόκληρες ώρες / Hante/hëngri në restorant për mbi dy orë

b. Επί δύο ολόκληρα χρόνια έτρωγε στο εστιατόριο / Επί δύο ολόκληρα χρόνια έφαγε στο εστιατόριο/Për mbi dy orë hante/hëngri në restorant

c. Επί δύο ολόκληρα χρόνια ζούσε σαν εργένης / Mbi dy vjet jetonte si beqar

Ndryshimi midis *επί δύο χρόνια ζούσε/έζησε σαν εργένης* (tregon vazhdimësi) dhe *επί δύο χρόνια έτρωγε/έφαγε στο εστιατόριο* (tregon përsëritje), ka të bëjë me kuptim e veçantë të foljes.

Lidhur me ndajfoljet e kategorisë B, atyre që tregojnë përsëritje, mund të mendohet se përdoren me të dyja format e aspektit. Këtë gjë e thekson dhe Xarxanosi⁶ që lidhur me aoristin thotë se dikur: “tregon diçka që është përsëritur disa herë: *Εννιά φορές τον έβαλε ο νιος το Χάρο κάτω. Εγώ πολλούς εγιάτρεψα*. Edhe tek ky grupim ndajfoljesh ka përjashtime si në rastin e shprehjeve që tregojnë përsëritje të përkohshme ose “të zakonshmen” si dhe *συχνά / shpesh, σπάνια / rrallë, πάντα / gjithmonë, κάθε μέρα/καθημερινά / çdo ditë*, të cilat sipas rregullit nuk zgjedhin aspektin e kryer:

a. Έβρεχε τρεις φορές την ημέρα / ?τρεις φορές/πολλές φορές/συχνά

b. Έβρεξε τρεις φορές (όλο και όλο) / ?τρεις φορές την ημέρα /πολλές φορές/*συχνά

⁶ A. Τζάρτζανος, *Νεοελληνική Σύνταξις*. ΟΕΣΒ. Bot. 1. 1946. Bot. 2. 1953.

Lidhjet e foljes me ndajfolje që tregojnë vazhdimësi e përsëritje në gjuhën greke

c. Έχει βρέξει τρεις φορές (όλο και όλο) / ?τρεις φορές την ημέρα /πολλές φορές/*συχνά

Ndajfolja *συχνά/shpesh* në përgjithësi e përjashton përdorimin e aspektit të kryer dhe në rastet kur përdoret me të kryerën e thjeshtë apo të kryerën, shfaqet në një farë mënyre abuzivisht, sepse ngatërrohet lehtë me shprehjet ndajfoljore *πολλές φορές/shumë herë* apo në *mënyrë të përsëritur / επανειλημμένα*. Shohim shembujt:

a. *Μου έχει γράψει συχνά/*Μου έγραψε συχνά

b. Μου έχει γράψει συχνά τέτοια γράμματα/μου έγραψε συχνά τέτοια γράμματα

Vërejmë se ndajfolja *συχνά* shkon më mirë me folje në aspektin e kryer kur nuk i referohet foljes, por një pjese tjetër të fjalisë. Fjalía e dytë nuk na tregon se veprimi i shprehur nga folja ka ndodhur shpesh, por letrat që shkroi ishin të shpeshta.

Vërejtje të ngjashme do të kishim edhe për ndajfoljen *πάντοτε/πάντα*, e cila gjatë përdorimit ngatërrohet me *διαρκώς, συνεχώς/συνέχεια*. Kur tregon përsëritje kjo ndajfolje ka mundësinë të përdoret me të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën:

a. *Πάντα σας έχω γράψει/*Πάντα σας έγραψα

b. Σας έχω γράψει πάντα με ειλικρίνεια/Σας έγραψα πάντα με ειλικρίνεια

Këta dy shembuj tregojnë se X ka qenë gjithmonë i singertë kur shkruante, por jo se shkruante gjithmonë, me singëritet apo jo. Duhet thënë dhe se kur kjo ndajfolje bashkohet me ndonjë tjetër të së njëjtës kategori, përdoret gjithmonë me të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën: *Όσες φορές μου ζήτησε χρήματα, πάντοτε του έδωσα*.

Të njëjtin arsyetim kemi dhe për ndajfoljen *ποτέ* / kurrë që nga ana leksikore është e kundërt me *πάντοτε/πάντα*. Kjo përdoret në mënyrë të padiskutueshme me aoristin: *Δεν σου έγραψα ποτέ* ose me të ardhmen (të vazhdueshme dhe të çastit): *Δεν θα σου γράψω ποτέ*. Përdorimin me të kryerën e ka më të kufizuar.

3. Përfundime

Si përfundim mund të themi se problemi i përdorimit të aspektit të kryer dhe të pakryer është një nga vështirësitë më të mëdha për studentët tanë që mësojnë greqisht. Kjo për faktin se gjuha shqipe nuk e ka kategorinë e aspektit. Folësi natyral i gjuhës e përdor saktë atë, por pa ditur të japë shpjegime pse përdori njërin në vend të tjetrit. Ndajfoljet e kohës luajnë një rol të rëndësishëm si mjet leksikor në përdorimin e saktë të aspektit. Por siç pamë dhe nga shembujt e shumë gjithmonë ka përjashtime.

Në të tilla raste propozimi ynë si mësimdhënëse së gjuhës greke ka qenë insistimi i vazhdueshëm që studentët, sidomos të vitit të parë, por jo vetëm, të

ndjekin në mënyrë të vazhdueshme kurse verore një apo dy mujore që zhvillohen në qytete të ndryshme të Greqisë.

BIBLIOGRAFI

- B. Comrie, *Aspect*. Cambridge University Press. 1976, f. 16.
R. Quirk, S. Grenbaum, *A University Grammar of English*, Londër: Longman. 1973.
Z. Vendler, *Linguistics in Philosophy*. Cornell University Press. 1967, f. 100.
A. Τζάρτζανος, *Νεοελληνική Σύνταξις*. ΟΕΣΒ. Bot. 1. 1946. Bot. 2. 1953.
M. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*: ΟΕΔΒ. Athinë. 1941, f. 184.